



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

-Sektori i Kuvendit-

01Nr. 60/01-27940/21
Kaçanik, 16.09.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **X-të (Dhjetë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2021 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 16 Shtator 2021. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përberja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarët-të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Festim Neziraj, Fatmir Loku dhe Ukshin Qallaku, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Fatlume Guri-Selimi dhe 2 zyrtarë nga kabineti i kryetarit.

Nga OJQ punimet e mbledhjes i përcolli Alban Muhaxheri-gazetar.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj, Zyrtare për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezentë në mbledhje janë të gjithë, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e X-të (Dhjetë) të Rregullt për vitin 2021, data 16 Shtator, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendim për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024;
3. Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022;
4. Raporti për zbatimin të rekomandimeve të Auditorit për pasqyrat vjetore 2020;
5. Propozim Vendimi për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022; dhe
6. Kërkesa e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Harmonizim të Vendimit 01Nr. 104/02-21139/21 të datës 30.07.2021- për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK 01.Nr.104/02-36179/19 i datës 29.11.2019 -Për Emërtimin dhe Riemërtimin e Rrugëve Lokale pas Shqyrtimit të Ankesave, Kërkesave dhe Propozimeve nga Qytetarët e Komunës së Kaçanikut.

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Faleminderit kryesues, iu përshëndes të gjithëve, atyre të cilët janë kandidat me marrë edhe një mandat, iu dëshiroj sukses. Lidhur me rendin e propozuar të punës, kërkoj që dy pikat për të cilat na është dërguar me vonë materiali, duhet me marrë miratimin e KK para se me shtruar në votim rendin e punës.

Kryesuesi i Kuvendit, Pika e 6 ka hyrë në rend pune me kërkesën time, pasi që e njëjta është kthyer nga MAPL. Është hera e dytë që kthehet ky vendim, kështu që kam propozim që të anulohet këtë vendim, ashtu që legjislatura vijuese të merret me këtë çështje. Përgjigja e Agjencionit siç me ka njoftuar drejtori është që të stopohet kjo çështje, pasi që në periudhë 10 vjeçare nuk kanë të drejtë të riemërtohen rrugët, kështu që kur të vijmë të pika 6 fjalën harmonizim të zëvendësojmë me anulim të vendimit. Meqë është kërkesë e MAP, ne duhet domosdoshmërisht të rishqyrtojnë si KK, se nuk dua me dalë si KK pa e rishqyrtuar një vendim të cilën na e ka kthyer MAPL dhe që të figuroj pastaj në raport si vendim i pa rishqyrtuar sipas kërkesës së MAPL.

z. Ekrem Kyçyku, Për dy pika të cilat na kanë ardhur me vonë, ne LVV konfirmoj së do të abstenohet.

Kryesuesi i Kuvendit, Pika 5 ka qenë në rend pune, e njëjta është dërguar edhe një herë për shkak të një gabimi teknik. Atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së IX-të (Nëntë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 31.08.2021 / Lënda: 01Nr. 060/01-25943/21.

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me kaluar në pikët e dytë, procedojmë me Pyetje dhe Kërkesa;

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Kaltrina Kodra (Tafili), Përshëndetje për të gjithë; Në rrugën “Burim Rexha” konkretisht të shtëpia e Xheladin Laçit, aty para 1 viti ka filluar ndërtimi i rrjetit të kanalizimit, mirëpo ky projekt ka mbetur në gjysmë, ashtu që katër (4) shtëpi kanë mbetur pa u kyçur në kanalizim. Cila është arsyeja që ka mbetur në gjysmë ky projekt ? Po në të njëjtën rrugë është realizuar projekti i ndriçimit publik, por edhe këtu është e njëjta situatë, sepse disa shtëpi të cilat kanë pasur nevojë për ndriçim publik, nuk kanë ndriçim publik, sepse projekti ka mbetur në gjysmë. Faleminderit !

z. Ekrem Kyçyku, Unë me shumë e kam si përgjigje për Bekim Koxha çështjen të cilën e ngriti nga mbledhja e kaluar kur u ngrit çështja e mbrojtjes së pyjeve. Shumë herë e kemi ngritur këtë çështje dhe kemi marrë masa brenda mundësive tona. Po të tregoj që qeveria e Kosovës e ka bërë një plan me titull: “Mbrojtja e pyjeve 2021”. Efektet e para të planit janë

parë në javën e kaluar, ku janë zënë 130 metra³ dru, aq sa nxihen këtu për 1 vit. Janë konfiskuar disa kamionë. Ky aktivitet ka vazhduar, ku të nesërmen ka pasur edhe të arrestuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Nuk është koha për debat, por pasi të është përmendur emri Bekim, e keni fjalën.

z. Bekim Koxha, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithëve; Iu uroj suksese të gjithë atyre që janë në garë me marrë edhe një mandat. Faleminderit për bashkëpunimin të gjithëve, konstruktivitetin që kemi pasur, ndoshta ndonjëherë kemi qenë kritikues, por nuk kemi pasur ndonjë interes personal, por për interes të qytetarëve e kemi ngritur zërin e tyre këtu. Sa i përket çështjen që e potencoj z. Ekrem Kyçyku, për mbrojtjen e pyjeve, unë e falënderoj shumë, me të vërtetë duhet falënderuar një aktivitet i tillë. Unë edhe pa me treguar z. Ekrem, e kam parë se ka pasur zhvillime, aksione të policisë, ndërkaq kush ka qenë iniciator nuk me intereson. Ne jemi këtu për me luftuar të keqën-dukuritë negative. Unë i falënderoj për punën dhe angazhimin që e kanë bërë si ministria, si pushtet lokal. Faleminderit !

Kryesuesi i Kuvendit, Pyetje dhe kërkesa të tjera nuk ka, atëherë kalojmë në pikën e radhës:

2. Propozim Vendim për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024;

Kryesuesi i Kuvendit, Siç e dini Projektbuxhetet duhet t'i nënshtrohen edhe debateve publike me qytetarë dhe me grupe të ndryshme të interesit. Besoj që Ekzekutivi i Komunës e ka kryer obligimin e tij ligjor që i takon për buxhetin, ndërkaq ne si KK nuk kemi arritur të realizojmë debate për buxhetin, për shkak të masave të Covid-19 që janë në fuqi, e që nuk lejohet grumbullimi i njerëzve, kështu që besoj se duhet të mjaftojnë debatet publike të cilat i ka organizuar ekzekutivi i komunës për buxhetin. Edhe një herë po e potencoj se KPF dhe KK nuk ka arritur t'i realizoj debatet publike për shkak të masave të cilat janë në fuqi. Në disa dëgjime publike të organizuara nga ekzekutivi i komunës kam marrë pjesë, besoj se qytetarët kanë pasur kohë me i adresuar kërkesat dhe nevojat e tyre përmes atyre dëgjimeve publike. Meqë është drejtori këtu, ia kisha kaluar fjalën për një rezymë të buxhetit, pastaj e hapim diskutimin e kësaj pike.

z. Bahri Selimi- drejtor i DEFZH, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithëve; Propozim Buxhetin e projektuar e kemi sjellë tek juve, ku kemi paraqitur projeksionet 2022-2024. Sot me tepër do të fokusohemi të buxheti i projektuar për vitin 2022, pasi që buxheti 2023 dhe 2024 janë vetëm vlerësime dhe mund të ndryshojnë. Buxheti për vitin 2022 do të jetë: 9,193,167.00 €. Mjetet nga Granti qeveritar (GQ) shënon ngjitje për 195,746€, ndërkaq GA (Granti i Arsimit), 172,047€, GSH (Granti i Shëndetësisë) nuk ka rritje. Të HVK kanë ngritje 42,775€ apo në total rritja e buxhetit është 410, 568€ apo afër 5%. Me ngritjen 5 % i kemi ngritur kategorinë e shpenzimeve, përpos të Kategorisë e pagave është njëjtë. Të Mallrat dhe Shërbimet ka ngritje 109.000€, Shpenzimet komunale rritje për 8.232000€ dhe Subvencionet dhe transferet kemi ngritje për 50.000€ më tepër dhe Investimet kapitale janë ngritur duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve të komunës, për 242.875€. Lista e projekteve iu ka bashkangjitur planit buxhetor, iu ka nënshtrua dëgjimeve publike nga Ekzekutivi i Komunës, ashtu siç e theksoj edhe kryesuesi i KK, ndërkaq nga KK nuk ka pasur dëgjime publike të organizuara. Mirëpo, pasi që ju jeni përfaqësues të qytetarëve, besoj se ditën e sotme e shfrytëzojmë për diskutim, dhe kërkojmë përkrahjen e këtij buxheti, së është buxhet i qytetarëve, dhe besoj se ne i kemi shterë të gjitha mundësitë, ku kemi bërë raport çka kanë kërkuar qytetarët, çka kemi pasur mundësi me inkorporuar në buxhet, sa nga projektet janë në realizim e sipër, sepse qytetarët nuk e kanë bash informacionin e plotë. Ka shumë projekte të cilat janë duke u realizuar me buxhet, kemi bërë shpjegime, dhe çka ka mbetur pa u realizuar.

Faleminderit për durimin që patët me dëgjuar. Unë jam këtu nëse ka ndonjë paqartësi dhe për ndonjë pyetje. Faleminderit shumë.

Kryesuesi i Kuvendit, Faleminderit drejtor, A ka kush me diskutuar rreth buxhetit të projektuar? E hapi diskutimin për këtë pikë:

znj. Arlinda Rakoci-Raka, Përshëndetje për të gjithë; Kur flasim për planifikimin buxhetor, mund të themi lirisht së jeni të dështuar, sepse keni vendosur vetëm tituj të projekteve, duke mos ndarë mjete për realizimin e tyre. Andaj ne (subjekti politik i LDK) do të votojmë kundër miratimit të buxhetit të projektuar.

z. Ekrem Kyçyku, Unë po tregoj së sot nuk kemi pasur ujë, ndërkaq në vitin 2022 të ndahen 130.000€ për ujë në Kaçanik, ndërkaq diku 100.000€ për ndriçim publik, për mua ndriçimi publik është lluks dhe një pjesë e mirë e fshatrave veç e kanë ndriçimin publik.

z. Adnan Reka, Faleminderit, përshëndetje për të gjithë; Ne parim, ne jemi kundër këtij buxhetit që ju e keni projektuar, por meqë është mbledhja e fundit e kësaj legjislature, ne nuk duam të marrin përgjegjësinë për mos aprovimin e këtij buxheti, prandaj ne do të abstenojmë në këtë vendim

z. Bekim Koxha, Faleminderit kryesues; Në bazë të shikimit të buxhetit, ne e kemi parë së që të sektori i bujqësisë janë ndarë 50.000€, shumë kjo e cila nuk po ndryshon asnjëherë. Nëpër fshatra po kemi fjalë të mëdha për bujqësinë, ndërkaq buxheti më të vërtetë është i mangët për zhvillimin e bujqësisë. Ne do ta përkrahim dhe do të votojmë për buxhetin, me mundësi që të rishikohet mundësia e përkrahjes së bujqësisë.

znj. Hafize Sallahu, Përshëndetje për të gjithë; Edhe ne subjekti politik i AAK-së jemi konsultuar për buxhetin e projektuar. Buxheti nuk është shumë i kënaqshëm, por do të përkrahim duke besuar që do të funksionoj pak me mirë dhe do të ketë një zgjidhje tjetër, së me të vërtetë janë disa projekte të pa prekura.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse nuk ka kush diçka, po flas unë rreth kësaj pike. Gjithnjë kur debatojmë buxhetin, buxheti është çështje e rëndësishme për KK, për arsye së bëhet fjalë për investimet dhe vlerën e parasë që do të investohet gjatë një viti. Për të gjithë ata të cilët donë mos me votuar buxhetin, gjejnë mënyra për mos me votuar. Edhe ata të cilët donë më votuar buxhetin gjejnë mënyra- gjejnë projekte në kuadër të buxhetit për me votuar buxhetin. Ne e dimë së nevojat nuk mundet me i përmbushë buxheti i komunës. Buxheti është ky që është, nuk mundem me rritur apo me ndryshuar, mundem me ndarë ndryshe, por jo me rritur apo me zvogëluar, kështu që besoj së në kuadër të nevojave që ka komuna, buxheti është ndarë në formën me të mirë të mundur, ndërsa mund të ketë pikëpamje të ndryshme se ka mundur me u bërë në këtë apo atë formë. Unë mendoj se për problemet e ujësjellësit dhe kanalizimeve, komunat duhet lirohen nga këto obligime, pasi që tarifat për këto i merr dikush tjetër. Meqë kemi kompani regjionale që janë ashtu si janë, ne jemi detyruar çdo herë si komunë në kuadër të këtyre projekteve të ndajmë mjete, për do punë që i përkasin dikujt tjetër.

Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komunës, Besim Ilazi, urdhëroni kryetar;

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Meqë është seanca e fundit e Kuvendit të Komunës, shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë veç e veç. Ka qenë një bashkëpunim i mirë jo gjithë herë ndoshta që me ka pëlqyer, kemi ka pasur mospajtime e kritika, megjithatë qëllimi ka qenë i përbashkët çdo herë dhe në interes të qytetarëve. Idetë e kundërshtimet kanë qenë të ndryshme, ndoshta shpesh herë kemi qenë në mospajtim me njeri tjetrin. Mund të themi këtu se ka pasur grupe të subjekteve politike të cilët

na kanë përkrahur në raste të caktuara, që ndoshta nuk e kemi merituar atë përkrahje, dhe kemi pasur GP apo anëtarë të KK të cilët na kanë kundërshtuar më tepër sesa e kemi merituar, por kritikën që i kanë bërë, i kanë vlerësuar së kanë qenë në shërbim dhe mirëqenie të qytetarëve të Kaçanikut, duke i ditur sfidat dhe kapacitetet të cilat i ka Komuna e Kaçanikut. Edhe ky buxhet i projektuar e di se nuk i përmbushë kërkesat e qytetarëve. E di që ka nevoja edhe më të mëdha të qytetarëve të komunës sesa vet buxheti, por megjithatë, edhe ne nuk mund të themi se kemi bërë mrekulli. Gjatë punës ne mund të kemi pasur gabime jo të qëllimshme, e di që gjatë punës nuk kemi qenë çdo herë në shërbim të qytetarëve të komunës, por megjithatë është një buxhet i cili është dashur t'iu prezantohet qytetarëve të komunës dhe t'iu tregohet se cili është buxheti. Kam kërkuar nga GQ dhe asamblistët në debatet publike të cilat janë mbajtur për buxhetin t'i jepni mendimet dhe vlerësimet në buxhetin e projektuar. Buxheti është ky që është, ai nuk mund të ngritët për asnjë cent, përpos ndryshimet brenda projekteve. Besoj kam qenë mirëkuptues dhe tolerant dhe kam kërkuar se ku të hiqet një projekt dhe të zëvendësohet me tjetrin. Shpesh herë kemi ardhur në aso situatë që kemi tërhequr mendimet apo vendimet tona dhe i kemi zëvendësuar me tjerat. Sot, për çudi, një subjekt politik që ka përkrahur në seancën e parë buxhetin dhe janë bërë ndryshime buxhetore me kërkesën e tij, thotë se nuk e votojmë buxhetin. Për mua kjo është paksa e habitshme, kur thuhet se nuk e votoj buxhetin i cili është në interes të qytetarëve. Kur nuk votohet me arsyetim së subjekti politik ka propozuar një prioritet dhe nuk ka hyrë në listë ai prioritet, ajo është diçka tjetër. Sido që të jetë është vlerësim i juaj dhe i qytetarëve të komunës. Uroj që gjithçka të bëhet në interes të qytetarëve. Jemi në fund të mandatit dhe përkundër këtyre mospajtimeve, uroj që qëllimin të kemi pasur të përbashkët- në interes të qytetarëve. Koha do të dëshmojë këtë më së miri, uroj që qytetarët të vlerësojnë këtë nëpër kohë. Normal do të merr ndëshkimin secili që ka gabuar, duke filluar nga unë si kryetar dhe të tjerët sa kanë mundur me përfaqësuar qytetarët. Edhe një herë, Uroj ata që janë në garë, shëndet, të kenë suksese, ndërkaq të tjerëve që nuk janë pjesë e garës, falënderues për të gjithëve për kontributin. Faleminderit !

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimin për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024; e shtroj në votim për aprovim. Në sallë kur u votua propozim buxheti, ishin 27 anëtarë. Për votuan 15 anëtarë, Kundër ishin 4 anëtarët nga LDK, Abstenuan 7 anëtarët nga LVV dhe Ekrem Raka nga IQ -Lista për Kaçanikun. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për MIRATIMIN e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024 / Lënda 01Nr. 400/03-26144/21.

3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, drejtori është prezent këtu, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim, Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022 dhe i njëjti u aprovua me 16 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 8 anëtarë; 6 nga LVV(Adnan Reka, Kaltrina Kodra (Tafil), Besim Vishi, Ekrem Kyçyku, Albana Lika (Troni) dhe Fatijona Kyçyku), Ekrem Raka nga IQ dhe Bekim Koxha nga NISMA. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022 / Lënda: 01Nr. 430/03-27288/21.

4. Raportin e zbatimit te rekomandimeve te Auditorit për pasqyrat vjetore 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Drejtori në kuadër të obligimeve ka bërë një raport në lidhje me zbatimin e rekomandimeve te Auditorit për pasqyrat vjetore 2020. Ky raport është sa për njoftim, pasi që nuk del në votim. Nëse keni diçka drejtor më shtuar urdhëroni;

z. Bahri Selimi, Materiali iu ka ardhur edhe një herë për shkak të korrigjimit të një gabimi teknik. Raporti është shqyrtuar edhe në KPF. Ky raport është periodik, raporti final sjellët në KK në muajin mars. Nga 6 të gjeturat si në raportin e auditorit, pjesërisht janë në zbatim e sipër të gjitha, deri në fund të vitit besoj së do të zbatohen të gjitha.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush më marrë fjalën urdhëroni; Meqë nuk u paraqit kush, atëherë konstatohet së kjo ishte sa për njoftimin tuaj. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës, u

Njoftua

Me Raportin e zbatimit te rekomandimeve te Auditorit për pasqyrat vjetore 2020/ Lënda:

5. Propozim Vendim për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit, Në mbledhjen e kaluar e patëm në shqyrtim këtë çështje, por nuk kaloj, ndoshta edhe ne nuk dhamë ndonjë arsyetim më të hollësishëm. Besoj së materiali ka qenë i qartë, sipas ligjit të ri për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, kërkohet që komunat një vit para se me i nxjerrë në shqyrtim pronat komunale, të kenë të publikuar listën në faqen e komunës. Ky është obligim ligjor i komunave. Komunat të cilat nuk e publikojnë 1 vit përpara listën për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, nuk mund t'i japin në shfrytëzim. Kjo listë është bërë nga Kryetari i Komunës dhe DUKMM në bazë të kërkesave të investitorëve apo atyre të cilëve janë të interesuar të investojnë në pronat komunale. Këto prona mund të jepen në shfrytëzim në vitin 2022 varësisht nga të interesuarit me investuar. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin për këtë pikë;

z. Adnan Reka, Jo more jo! Ne nuk pajtohemi me aprovimin e listës për shpërndarjen e pronës komunale me qëllim elektorale një muaj para zgjedhjeve. Kryetar! Ja t 'fillojmë nga malet si pasuri komunale, ju lejuat prerjen e tyre në mënyrën me mizore, me pas lejuat gërryerjen e kodrave për ta eksploatuar gurin, dhe me pas, lejuat mbushjen e tyre me mbeturina. Po të shohim lumenjtë si pasuri e komunës, i shkatërruat me themel duke dhënë Pëlqim për mini-hidrocentrale, apo duke lejuar shkarkimin e të gjitha kanalizimeve të komunës tonë dhe të Ferizajt, dhe i batë kanalizime të hapura që kundërmojnë në të gjitha fshatrat dhe qytetin e Komunës së Kaçanikut. Ndërsa tani, me tokat e mbetura të Komunës doni të bëni fushatë, të bëni pazarllëqe t 'nivelit me të ulët, t'i mashtroni qytetarët. Dhe, përveç mashtrimeve ju asgjë nuk do të bëni, do të veproni njëjtë siç vepruat me Komisionin për dhënien e banesave sociale, do ta dërgoni Vendimin në MAPL, dhe MAPL do ta hedh poshtë si Vendim i kundërligjshëm. Sigurisht të nesërmen do të dilni me ndonjë status në FB ku do të thoni " LVV është kundër investimeve Gjermane" Kryetar, e keni humbur arsyen fare, sepse me t 'vërtetë këtë nuk mund ta bëjë një Kryetar që sado pak e donë komunën që e udhëheq.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Faleminderit Adnan; E di së jemi në fushatë dhe fushata ka filluar sot dhe mirë po ia fillon me kënduar këto poezitë e juaja qysh i keni mësuar dhe po dua

me t'i argumentuar: Për të pyjet, që nga 3 vite na keni lodhur duke bërë titull këtu, ndërkaq që nga 6 muaj diqysh e keni ndaluar zërin krejt, sepse është kompetencë e juaja – e qeverisë që e keni dhe jo e kryetarit të komunës dhe ky veprim i cili u tha sot për pyjet, nuk është i qeverisë, por e vullnetit, e komandantit të policisë, për të cilin e kam përgatitur një mirënjohje me ia dhënë. Për Parkun nacional, ju i dini shumë mirë kompetencat e komunës cilat janë për parkun nacional. E dyta, e dini edhe për lumenjtë kompetencë e kujt është dhe rrjedhjen e lumit Neredime qysh mundemi me ndalë prej Ferizajt dhe ti me qenë kryetar qysh e kishe ndalur. Një arsye po ta them shumë drejtë, ende kryeqyteti nuk i ka kryer trajtimin e ujërave të zeza, e po pret që Kaçaniku t'i kryej para të gjithëve sipas teje. Dhe, vendimi tjetër (ndarja e banesave), mos me zgjatur, e kam marrë me qëllimin më të mirë me i futur asamblistët të partive politike që mos me dyshuar që kryetari po keqpërdor ndarjen e tyre. Edhe pse vendimi na është kthyer së është kompetencë e kryetarit, dhe nuk do ta bëjë ndarjen e banesave deri sa të kryhet fushata, për më të shëndoshë edhe ty, së nuk e kam atë qëllim me marrë pushtetin. A jam kryetar i mirë apo i keq nuk vlerësohet nga Adnani, por vlerësohet nga qytetarët. Qysh e vlerësojnë qytetarët, është koha për me dëshmuar më së miri. Uroj të zgjedhim më të mirin, nuk e di cili është ai, por është vlerësim që do ta merr ai i cili do të zgjidhet kryetar, e jo personalitete të caktuara të partive politike apo kryetarit të komunës.

z. Adnan Reka, -Replikë, Kryetar në rregull, për mua pyetja është; Pse PDK për pyjet që 1 muaj ditë para zgjedhjeve paska lënë me i marrë këto veprime, që ti po pretendon së i ka bërë niveli lokal. Që 4 vjet e keni lënë me u shkatërruar pyjet në legjislaturën tënde sa jam edhe unë në këtë legjislaturë. Ne vazhdimisht kemi kërkuar me u ndërmarrë diçka, paske mundur, por nuk paske vepruar. E dyta, pronat, listat e tyre, që 3 vite nuk i keni listuar, por i keni lënë në muajin e fundit. Lumenjtë, arsyetime ka sa të duash, por pëlqimin ju e keni dhënë, Pa e pasur pëlqim as ministria nuk kishte mundur me bërë gjë. E treta, për lumin Neredime, çka keni bërë, a keni bërë ndonjë investim, jo për impiantin, por cili veprim është marrë për me pastruar-filtruar që kanalizimet mos me u derdhur drejtpërdrejtë në lumin neredime ? Po t'i shikojmë nga këtu e deri të "Xhamia e Dëshmorëve", janë më së paku nga 20 kanalizime të cilat derdhen direkt në lum. Cili është veprimi konkret të cilin e keni marrë me i ndalur këto ? Këto janë veprime që ju nuk i keni bërë, ndërkaq është dashur me i bërë.

Kryetari i Komunës, Sa i përket komandantit të policisë, vazhdimisht e kemi potencuar, ka qenë vullnet i tij, unë nuk e kam urdhëruar (me marrë veprime për mbrojtjen e pyjeve), mundeni me shkuar e me pyetur. Edhe me parkun nacional, e din edhe Ekremi e kemi formuar Task Forcën që ka qenë në krye të task forcës bashkë me ne. Të gjitha kapacitetet dhe mundësitë që ka pasur kryetari ua ka mundësuar. Këto kanë qenë kapacitetet tona. E dyta, të lumenjtë, e kemi lumin Lepenc dhe lumin Neredime që derdhen ujërat e zeza, por nuk është ndotës i lumenjeve Komuna e Kaçaniku, por është Ferizaj. Çka kemi bërë ne për Ferizaj? Në vitin 2016 iu kemi drejtuar me kërkesë Komunës së Ferizajt. Kemi shpronësuar pronë në Komunën e Kaçanikut për shkak të territorit i cili iu duhet me bërë impiantin, por ende nuk ka filluar ndërtimi i impiantit. Vendimi është marrë në KK për shpronësimin e atyre pronave, ku do të kyçen në atë impiant pjesa e zonës së Elezajve- fshatrat që do të kyçen është marrëveshje që e kemi bërë për fshatrat që do të kyçen në atë impiant. Përpjekjet e kryetarit të Ferizajt janë bërë nuk janë arritur. Unë si kryetar çka kam bërë, dy herë në vit i kam dërguar shkresë Kryetarit të Ferizajt me shqetësimet e banorëve të Kaçanikut, ia kam dërguar inspektoratit të ambientit, ministrisë së ambientit, të gjithë ministrave. Këto kanë qenë mundësitë të cilat i kam shfrytëzuar me atë kompetencë që kam. Nuk kam mundur me ndryshuar dhe as sot nuk mundem, edhe ti me qenë Adnan nuk mundesh me ndryshuar, qejf mundemi me iu bërë njerëzve, por nuk mundem me ndryshuar. Të pronat, ne e kemi pasur si propozim dhënien në shfrytëzim, sepse e kemi pasur si sfidë këtë vit. Në vitin e kaluar nuk e kemi publikuar listën dhe kompania "Golden Igël" që ka qenë e interesuar dhe një pronë që e kemi pasur në Ivajë

nuk kemi mundur me ia dhënë pronën në shfrytëzim, për shkak të mos publikimit të listës së pronës deri në dhjetor të vitit të kaluar. Pronat të cilat epën në shfrytëzim, përsëri kanë me u miratuar në KK. Nëse dikush e vlerëson së një pronë është në interes të komunës, dhe nuk publikohet prona, atëherë nuk mund të jepet në shfrytëzim. Cilido që e merr pushtetin ka me publikuar listën e pronave të cilat epën në shfrytëzim në vitin vijues, por pse me humbur një vit, se mund të na ofrohet ndonjë investitor, kjo ka qenë arsyeja. Nëse nuk e miratojmë listën, unë mendoj se po ia bëjmë një dëm qytetarëve, sepse kanë filluar me ardhur investitor. Kjo ka qenë mundësia ime me sjellë këtë listë në KK për miratim.

z. Adnan Reka, Shpronësimin e përmende për trajtimin e ujërave të zeza në Gërlicë në territor të Komunës së Kaçanikut, çfarë pune pat komuna me shpronësuar pronë impiant për Komunën e Ferizajt? A nuk paska komuna e Ferizajt prona mjaft për impiant për trajtimin e ujërave të zeza. Nëse po u dashka impiant për Kaçanikun atje, kanalizimet të gjithë e dimë së shkojnë teposhtë e jo përpjetë.

Kryesuesi i Kuvendit, Një pjesë e territorit të Kaçanikut që janë nga Lushi shkojnë përpjetë kah Ferizaj, Unë jam duke udhëhequr mbledhjen, ndërkaq nuk ke të drejtë me merr fjalën disa herë në pyetje dhe përgjigje.

z. Bekim Koxha, Unë po e shoh se ka filluar fushata me tone të larta, me çka nesër mund të jetë edhe me e ashpër fushata. Po me vjen shumë keq, kjo nuk është një gjuhë e nivelit tonë për me diskutuar. Ka pasur kohë Adnan, ka pasur kohë Kryetar ku është diskutuar edhe për dështime edhe për meritat për të cilat iu falënderojmë dhe iu respektojmë shumë për punët e mira të cilat i keni bërë. Punët e këqija e kemi obligim me iu thanë së janë të këqija, së nuk janë bërë, pse nuk janë bërë, arsyen duhet me dhënë para qytetarëve. Ne jemi ankuar gjithmonë për lumin Lepenc për hidrocentralin. E kemi ngritur zërin aq sa kemi pasur fuqi, një votë e kam pasur jam kanë i vogël, por kam qenë zë i arsyeshëm. Jemi ankuar për malet- prerjen e pyjeve, nuk jemi ndalur asnjëherë për prerjen e pyjeve. Kur është ndalur prerja e pyjeve, kur ka pasur aksione të mira, i falënderoj aksionet e tilla, pavarësisht nga vijnë iniciativat, kjo është e mirë. Për impiantin e ujërave të zeza, është çështje shumë e madhe, është vështirë me duruar atë kundërmim gjithë qytetarët e Komunës së Kaçanikut, Stagovës, Kaçanik të Vjetër etj. Pse nuk u bërë impianti, nuk e di arsyen, është projekt i madh që kushton shumë. Unë e kam pas dhënë një ide që ujërat e zeza të mblidhen e të nxihen me gypa prej atje ku është Gërlica të bien diku përfund Kaçanikut dhe të bëhet impianti i përbashkët që kishte me qenë zgjidhje për Kaçanikun, Ferizajn dhe pshton lumi lepenc nga ndotja. Ky projekt kishte me bërë zgjidhje për tri komuna. Të pronat, i kemi kundërshtuar dhe jemi kundër dhënies së tyre në shfrytëzim, nga fillimi i kemi kundërshtuar, sepse mendojmë së këto prona janë dhënë pa interes të komunës. Komuna nuk ka përfituar asgjë, fjala vjen. Fjala vjen, çka ka përfituar komuna investime për pronën të pjesa e Fushës së Pajtimit që është dhënë në shfrytëzim, nuk ka përfituar asgjë. E ka përfituar një betonjerkë që e ndotë ambientin aty, qendrën kryesore të komunës së Kaçanikut e ka marrë një betonjerkë. Ne nuk jemi pajtuar asnjëherë dhe nuk pajtohem edhe tani, e kemi kundërshtuar dhënie në shfrytëzim të pronave komunale të cilat i janë dhënë Gërlicës dhe Mujës. Sa kanë pasur afat këto kompani me investuar dhe a kanë investuar, pse nuk iu kanë marrë ato prona, sepse ato është dashur me i marrë komuna, me i kthyer me i bërë përsëri prona të komunës, por kjo nuk është bërë. I kemi kundërshtuar dhe tani i kundërshtojmë, sepse jemi kundër dhënies së pronave komunale në shfrytëzim njerëzve të cilët nuk e meritojnë dhe pa interes të komunës. Komuna duhet me pasur interesin e vet, se pa pasur qira, me pasur interesin e vet komuna që me zbutur papunësinë, ne nuk pajtohem me u dhënë në shfrytëzim pronat komunale, ndërkaq komuna nuk ka pasur asnjë interes. Çka ka përfituar komuna investime nga dhënia e pronave komunale në shfrytëzim e kemi kundërshtuar edhe "Kivo" që nuk ka mundur me përfituar atë pjesën që e ka kërkuar dhe i njëjti ka shkuar në Ferizaj dhe ka

investuar dhe ne nuk kemi pasur fuqi me ndryshuar. Unë jam kundër -NISMA është kundër këtyre vendimeve, unë jam edhe kundër debateve që u zhvilluan sot, me treguar patriotizëm së kush çka ka bërë. Për 4 vjet jemi kanë këtu dhe i dimë së çka është bërë. Qytetarët janë ata të cilët duhet të vlerësojnë edhe punën edhe mos punën. Qytetari është ai që vlerëson sa kemi punuar, sa kemi qenë zë për qytetarët, dhe çka kemi bërë për qytetarin.

z. Ekrem Raka, Faleminderit kryesues; Unë e mora fjalën, kërkova me herët me marrë fjalën, por e mori Bekimi. Pjesa e parë që e tha Bekimi, nuk qëndron fare hiq. Debatin në mes të kryetarit dhe Adnan Reka ishte debat puro politik, nuk ishte fushatë. Ndërhyrjet personale ishin brenda agjendës, unë nuk e pashë si fushatë. Fushata, edhe nëse është fushatë, fushata ka filluar sot zyrtarisht. E dyta kryesues, ta kam tërhequr vërejtjen disa herë, mos e ngrit debatin në KK, kuvendi nuk është i yti as i kryetarit, ne secili anëtar i KK i kemi 10 minuta në dispozicion me diskutuar. Besoj se kemi qenë goxha konstruktiv. Për 4 vit unë nuk kam përdorur gjuhë jo parlamentare, që është e vërtetë kjo, prandaj të lutem, me krijo hapësirë me debatuar siç duhet, shihemi pastaj.

Kryesuesi i Kuvendit, Unë asnjëherë nuk e kam penguar debatin, kam lejuar me shumë saqë e lejon rregullorja e KK. Nëse e lexon rregulloren e punës së KK, e sheh sesa herë ka të drejtë një anëtar i KK me marrë fjalën për një çështje, edhe kur flet jashtë rendit të ditës, dhe nuk e kam penguar. Janë incizimet, janë transkriptet dhe mundesh me i parë sa herë të duash. Ka pasur diskutime që kanë qenë jashtë rregullores së punës së KK, por, me mirëkuptim të gjithëve i kemi toleruar. Sa jeni falënderues që keni qenë konstruktiv unë e thashë para teje, në fillim të mbledhjes. E thashë së jam mirënjohës për secilin anëtar për aktivitetin, konstruktiv dhe gjuhën e mirë që është përdorur në KK. E thashë, ndoshta nuk e paske dëgjuar, kur e fillova mbledhjen e thashë. Absolutisht nuk qëndron ajo që e thua, se jam munduar me krijuar një debat edhe jashtë asaj që parasheh rregullorja, sepse e kam parë së ka debat konstruktiv, ndërkaq nuk ka debat për fyerje e etiketime. Jemi këtu me debatuar dhe gjatë debateve ndoshta kam diskutuar edhe ton të lartë, por asnjëherë nuk ka qenë në atë frymën me ofenduar apo lënduar dike. Nuk kam asgjë në mes të debatit që ishte në mes Adnanit dhe kryetarit, përpos asaj që po debatohet në mes dy vetave, KK po mbetet në aut dhe këtë e ndalon edhe rregullorja.

znj. Hafize Sallahu, Kryesues, unë desha të lidhem me pikën që jemi tash. Ne si AAK listën e pronave do ta votojmë, duke shpresuar ata që do të vijnë në KK do të votojmë më së mirë veç e veç për secilën pronë, duke parë së çfarë investitori vjen.

z. Selim Reka, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Ne e dimë rëndësinë që ka shfrytëzimi i pronave, por pasi që jemi në kohë fushate, ne LDK-a e kemi marrë një vendim që për momentin nuk do të votojmë, pasi që mendojmë së shansa nuk do të humbet, pasi që KK i ri ka mundësi edhe gjatë dhjetorit me aprovua një listë të tillë.

Kryesuesi i Kuvendit, Se a ka mundësi apo jo me u miratuar lista në dhjetor, unë sinqerisht e themi së nuk e di.

z. Bekim Koxha, I mbeta borxh pak Ekremi, nuk e pata kuptimin pa keqkuptim diskutimin mes Adnanit dhe kryetarit, por gjuha mu dok pak e ashpër tani në mbledhjen e fundit. Tani jemi në fushatë, ka pasur kohë edhe për debate publike edhe për punët e mira që i ka bërë kryetari që më i treguar qytetarit, dhe për mos punë, ne si opozitë jemi kanë këtu dhe i kemi thënë këtu së këto punë janë të këqija. Kryetari do të arsyetohet para qytetarit, ndërkaq nuk isha asgjë kundër debatit, sepse vet jam një prej atyre që kam dëshirë me pasur debat edhe kur nuk pajtohem me diçka.

znj. **Kaltrina Kodra (Tafili)**, Faleminderit kryesues; Desha një pyetje për Bekimin për debatin që e përsëriti për gjuhën e përdorur; A mundesh me na treguar saktësisht ku të pengoj gjuha e cila u përdor këtu në debat ?

z. Bekim Koxha, Përgjigje në pyetjen e parafolëses, E pash së dolën jashtë temës që ishte temë e debatit.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendim për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022, e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit ishte 13 votë Për, 14 votë Kundër. Abstenime nuk ka. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë :

VENDIM

Për Refuzimin e Propozim Vendimit për miratimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022.

6. Kërkesa e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Harmonizim të Vendimit 01Nr. 104/02-21139/21 të datës 30.07.2021- për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK 01.Nr.104/02-36179/19 i datës 29.11.2019 -Për Emërtimin dhe Riemërtimin e Rrugëve Lokale pas Shqyrtimit të Ankesave, Kërkesave dhe Propozimeve nga Qytetarët e Komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit, Ministria përkatëse (MMPH) ka kërkuar harmonizimin e vendimit me legjislacionin në fuqi dhe në aspektin teknik. Në ndërkohë lidhur me këtë çështje, DUKMM iu ka drejtuar me një kërkesë Agjencisë kadastrale. Ata të ministrisë kanë kërkuar që për momentin me stopua këtë çështje, sepse duhet me i klasifikuar rrugët të cilat kanë qenë të emërtuara, të cilat nuk mund të riemërtohen në një periudhë 10 vjeçare. Deri sa të sqarohet kjo punë mes drejtorisë së urbanizmi dhe agjencisë kadastrale, unë mendoj që vendimin e mbledhjes së fundit ta anulojmë, në mënyrë që KK pastaj të merret me këtë çështje. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Propozim vendimin për anulim të vendimit e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 20 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 7 anëtarë. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Anulimin e Vendimit 01Nr. 104/02-21139/21 të datës 30.07.2021 për ndryshim plotësimin e vendimit për Ri-emërtimin dhe Riemërtimin e Rrugëve Lokale pas Shqyrtimit të Ankesave, Kërkesave dhe Propozimeve nga Qytetarët e Komunës së Kaçanikut/ Lënda:

Kryesuesi i Kuvendit, Për fund, si në çdo mandat tjetër, edhe këtë herë, Kryetari i Komunës ndan nga një plaketë mirënjohje të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për punën dhe angazhimin e tyre në mandatin 4 vjeçar të legjislaturës së gjashtë (6).

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 12:27.

Procesmbajtës

Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

